

Siguri

# Hajnat e maskuar futen në një shtëpi në Ferizaj – pronarja raporton se iu vodhën 30 mijë euro ari dhe një Beretta



Sinjali.com

12 Gusht 2026 21:27



**Një vjedhje e rëndë me dëm të konsiderueshëm është raportuar në fshatin Bibaj të Ferizajt, ku dy persona të maskuar dyshohet se kanë depërtuar në një shtëpi dhe kanë marrë stoli ari në vlerë prej dhjetëra mijëra eurosh, si dhe një armë, mëson Sinjali.**

Burimet e **Sinjalit** bëjnë të ditur se rastin në Polici e ka raportuar V.H. rreth 45-vjeçare e cila ka deklaruar se persona të panjohur i kishin hyrë në shtëpi dhe i kishin vjedhur stoli ari në vlerë rreth 30 mijë euro.

Përveç stolive, sipas deklaramit të saj, është marrë edhe një **Beretta me leje, vlera e së cilës është rreth 1,800 euro.**

Pamjet e kamerave të sigurisë pritet të jenë një nga provat kryesore për hetuesit. Sipas ankueses, në incizime shihen dy persona të maskuar duke hyrë në shtëpi dhe duke marrë gjërat me vlerë.

Policia është njoftuar për rastin më 11 gusht, ndërsa në vendin e ngjarjes kanë dalë edhe hetuesit dhe njësia e Forenzikës Rajonale, të cilët kanë nisur veprimet për identifikimin e autorëve.

Rasti po hetohet si “Vjedhje e rëndë”.

***Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!***

***/GazetaSinjali/***

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



## Lajme

Zgjedhjet 2026  
Kosovë  
Shqipëri  
Rajon  
Diasporë  
Evropë  
Botë

## Aktualitet

Politikë  
Drejtësi  
Siguri  
Shëndetësi  
Arsim  
Sociale

## Hulumtime

Ekskluzive  
Profile  
Skandaloze

## Ekonomi

Prodhime Vendore  
Financa  
Biznes

## Sport

Botërori 2026  
Futboll  
Basketboll  
Sporte Luftarake  
Sporte të tjera

## Showbiz

Bota e Yjeve  
Modë & Stil  
Bukuri dhe kujdes  
Të tjera

## OP-ED

Analizë  
Kolumne  
Intervistë

## Jetë

Fitnes  
Ushqime  
Travel  
Këshilla  
Receta  
Dieta  
Shëndeti

## Kulturë

Film  
Muzikë  
TV & Radio  
Libra  
Art & Dizajn  
Fotografi  
Histori

## Tech & Auto

Teknologji  
Automjete  
Telefona  
Internet  
Lojëra  
Aplikacione

## Fun

Qesharake  
Kuriozitete  
Kuize  
Fakte  
Të tjera